



1008/3

UDHËZIM PLOTËSUES

6.6.2023

Nr. 2/1, datë 6.6.2023
"PËR

NJË SHITESË NË UDHËZIMIN PLOTËSUES NR. 2, DATË 19.01.2023 'PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2023'

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë". të ndryshuar, nenit 21, të ligjit 84/2022, "Për Buxhetin e vitit 2023" dhe në vijim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", paragrafi 2.

UDHËZOJ :

Në Udhëzimin Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2023", në kreun 1. "Procedura specifike shtesë për zbatimin e Buxhetit të Shtetit", bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 90, shtohet gërma "y", me këtë përmbajtje:

"y". Të ardhurat e gjeneruara nga tarifat që paguhen në zonat e mbrojtura në zbatim të VKM nr. 1156, datë 24.12.2022, të ndryshuar.

2. Në pikën 91, hiqet gërma "l".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

